



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 24 nëntor 2011
Nr. Ref.: RK125 /11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 31/11

Parashtruesi

Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë – Tubimi Regjional Gjakovë

Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Bordit të Drejtorëve të komunës së Gjakovës, të 18 janarit 2011, dhe i vendimit të drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në komunën e Gjakovës, të 19 janarit 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë – Tubimi Regjional Gjakovë, nga Gjakova, e përfaqësuar nga kryetari i Tubimit Regjional të Gjakovës, z. Teki Bokshi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston vendimin e Bordit të Drejtorëve të komunës së Gjakovës, të 18 janarit 2011, dhe vendimin e drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në komunën e Gjakovës, të 19 janarit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i kushtetutshmërisë së (1) vendimit të Bordit të Drejtorëve të komunës së Gjakovës, të 18 janarit 2011, sipas të cilit personi nuk mund ta regjistrojë automjetin nëse nuk mund të konfirmojë që e ka paguar faturën e ngrohjes dhe tatimin e kompanisë, dhe (2) i vendimit të drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në komunën e Gjakovës, të 19 janarit 2011, për zbatimin e atij vendimi.
4. Parashtruesi pohon që vendimet e sipërpërmendura i shkelin nenet 7 [Vlerat], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Përveç kësaj, parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata vënien e masës së përkohshme për ta pezulluar zbatimin e vendimit të kontestuar derisa Gjykata të marrë vendim përfundimtar.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit (Nr. 03/L-121) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Gjykatë më 2 mars 2011.
8. Më 19 prill 2011, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 31/11, e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 31/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.
9. Më 11 maj 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Bordit të Drejtorëve të komunës së Gjakovës dhe drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në komunën e Gjakovës.
10. Më 8 qershor 2011, Gjykata kërkoi sqarim shtesë nga parashtruesi lidhur me atë se kush është parashtrues. Gjykata nuk ka marrë asnjë përgjigje deri më tani.
11. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 4 tetor 2011 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 18 janar 2011, Bordi i Drejtorëve të komunës së Gjakovës miratoi vendimin që personat fizikë dhe juridikë nuk mund t'i regjistrojnë automjetet nëse nuk marrin vërtetim nga Ngrohtorja e Qytetit se i kanë paguar faturat e ngrohjes dhe, në rastin e

personave juridikë, vërtetimin nga Kuvendi Komunal i Gjakovës se i kanë paguar tatimet e kompanisë së tyre.

13. Më 19 janar 2011, vendimi i 18 janarit 2011 u zbatua nëpërmjet një vendimi të drejtorit të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik të komunës së Gjakovës.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi thekson se Ngrohtorja e Qytetit nuk lëshon vërtetim nëse personi i ka paguar faturat e ngrohjes dhe Kuvendi Komunal i Gjakovës nuk lëshon vërtetim nëse personi e ka paguar tatimin e kompanisë.
15. Vendimi i 18 janarit 2011 është gjoja jokushtetues pasi e kufizon/apo pamundëson regjistrimin e automjetit. Prandaj, ai shkel nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës pasi automjeti është mjet i rëndësishëm transporti në mënyrë që avokati t'i zhvillojë veprimtaritë që lidhen me profesionin e tij. Ai gjithashtu shkel nenet 7 [Vlerat], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.
16. Përveç kësaj, parashtruesi pohon që avokatët nuk duhet të paguajnë tatim të kompanisë pasi janë të regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës e jo në komunë, dhe as në Agjencinë e Kosovës për Regjistrimin e Bizneseve. Pasi janë të regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës, avokatët marrin licencë dhe autorizim për punë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Parashtruesi pohon që vendimi të cilin e ka nxjerrë Bordi i Drejtorëve i komunës së Gjakovës më 18 janar 2011, i zbatuar nga Drejtoria e komunës për Zhvillim Ekonomik të nesërmen, ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 7 [Vlerat], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.
18. Për të gjykuar për ankesën e parashtruesit, Gjykata vëren që ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, parashtruesi duhet së pari të tregojë që të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë janë cenuar personalisht apo drejtpërdrejt nga akti i organit publik. Nëse parashtruesi nuk është në gjendje ta bëjë këtë, ai nuk ka pozitë të viktimit në Gjykatë.
20. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parashtruesi as nuk ka treguar që ishte personalisht apo drejtpërdrejt i cenuar nga vendimet e kontestuara, as nuk ka dorëzuar ndonjë provë që ai është, në të vërtetë, i autorizuar nga ata për të cilët pohon të jenë drejtpërdrejt viktimat të vendimit të kontestuar, për t'i përfaqësuar interesat e tyre në Gjykatë.
21. Prandaj, rezulton që kërkesa është e papranueshme në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

22. Sa i përket kërkesës së parashtruesit drejtuar Gjykatës për masë të përkohshme, Gjykata i referohet nenit 27 të Ligjit dhe, në veçanti, rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, i cili thotë që, në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme. Megjithatë, duke marrë parasysh që kërkesa u shpall e papranueshme,

parashtruesi nuk ka të drejtë, sipas rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, të kërkojë masë të përkohshme.


PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese më 23 nëntor 2011,

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Dr. Gjyljeta Mushkolaj



Kryetari i Gjykatës Kushtetues


Prof. Dr. Enver Hasani